

Kopshti i fëmijëve

**në pjesën gjermane
të kantonit të Bernës**



Informata për prindër

Drejtoria për Edukim dhe Arsimim
e Kantonit të Bernës

Shënim:

Botuesi dhe e drejta e autorit:
Drejtoria për Edukim dhe Arsimim e Kantonit të Bernës

Botimi i parë: gusht 2001

Porosia:
Berner Lehrmittel und Medienverlag

Të dashur prindër

Hyrja në kopshtin e fëmijëve për ju dhe për fëmijën tuaj është një ngjarje e veçantë. Ndoshta fëmija juaj veç ka qenë në një grup loje ose kopsht ditor fëmijësh. Fillimi i ndjekjes së kopshtit të fëmijëve është një hap më tutje drejt pavarësisht vetjak. Me këtë është i lidhur integrimi në një grup më të madh fëmijësh dhe hyrja në shkollimin fillor. Ne gëzohemi që me këtë rast ju japim një pasqyrë të organizimit, qëllimit dhe formave të punës në kopshtin e fëmijëve

Drejtoria për Edukim dhe Arsimim

Ofertat e kopshtit të fëmijëve

Bashkësia e fëmijëve

Në kopshtin e fëmijëve fëmija juaj takon një grup fëmijësh, zhvillimi i të cilëve si në gjuhë, në moshë poashtu edhe në gjendjen familjare mund të ndryshojnë. Bashkarisht fëmijët në shoqëri do të luajnë dhe mësojnë me njëri-tjetrin.

Personeli arsimor për kopshtin e fëmijëve

Grupi udhëhiqet nga personeli arsimor i shkolluar për kopshtin e fëmijëve. Ky përfshinë aftësitë dhe interesat e fëmijëve. Ofron lojëra dhe mjete mësimore të gatshme, të cilat fëmijëve iu mundësojnë përvojat e reja si dhe ndihmojnë në zhvillimin dhe nxitjen e tyre. Këtu grupi orientohet në qëllimet e përcaktuara të planit mësimor.

Lokalet e mësimiit dhe lojës

Në kopshtin e fëmijëve, fëmijët gjejnë trajtim të përshatshëm për thellimin e lojës dhe të mësimiit. Ata do të gjallërohen me veprimtarinë, eksperimentimin dhe organizimin vetjak. Në aktivitetin e tyre do të ndihmohen dhe udhëhiqen nga personeli arsimor.

Kohëzgjatja e kopshtit të fëmijëve dhe orari në kopshtin e fëmijëve

Kohëzgjatja e kopshtit të fëmijëve

Çdo fëmijë ka të drejtë që para se të hyjë në shkollë, së paku një vit të ndjek kopshtin e fëmijëve. Një vit i dytë në kopshtin e fëmijëve mund të ndiqet me ofertën e komunës. Edhe pse vijimi në kopshtin e fëmijëve është vullnetar, atë e ndjekin gati të gjithë fëmijët së paku një vit.

Orari në kopshtin e fëmijëve

Numri i orëve të mësimin në kopshtin e fëmijëve është i varur nga numri i javëve shkollore në venbanimin tuaj. Te 39 javë shkollore janë për shembull të paktën 22 dhe më së shumti 25 orë mësimore në javë. Koha e përditshme në kopshtin e fëmijëve është e përcaktuar nga komisioni përgjegjës i komunës. Për fëmijët, të cilët ndjekin dy vite kopshtin e fëmijëve, ka mundësi që në vitin e parë t'iu shkurtohet kohëzgjatja javore në kopshtin e fëmijëve.

Mungesat

Fëmijët e vijnë rregullisht kopshtin e fëmijëve. Kur ata mungojnë (për shembull: për shkak të sëmurjes së fëmijës apo për shkak të pushimeve të prindërve) duhet të njoftohet personeli arsimor me kohë ose më së voni para fillimit të mësimin. Personeli arsimor interesohe për vendqëndrimin e fëmijëve të palajmëruar.

Rruga për në kopshtin e fëmijëve

Në rrugën për në kopshtin e fëmijëve dhe anasjelltas fëmijët gjenden nën përgjegjësinë e prindërve.

Të ndihmohet dhe nxitet zhvillimi i fëmijëve

Aftësitë dhe interesat e fëmijëve

Fëmijët në kopshtin e fëmijëve sjellin me vete premisa, përvoja dhe aftësi të ndryshme. Personeli arsimor kap nivelin e zhvillimit të fëmijëve përmes vrojtimit dhe përmes bisedës me prindërit. Ai njih aftësitë dhe dhuntitë, dobësitë dhe mangësitë, interesat dhe nevojat duke krijuar në këtë mënyrë një mirëkuptim për sjelljet dhe përjetimet e fëmijëve.

Mbi këtë bazë planifikon dhe organizon punën e tij me fëmijët.

Rënia në sy gjatë zhvillimit të fëmijëve

Veçoritë në zhvillimin e çdo fëmije bien në sy shpesh për herë të parë në kopshtin e fëmijëve. Nëpërmjet mbështetjes së veçantë do të jepen impulse të zhvillimit të fëmijës duke vënë në lëvizje procesin e mësimin.

Puna e instancave të specializuara

Për sqarimin, këshillimin dhe oferta të posaçme mund të drejtoheni te personeli arsimor i specializuar. Sipas rregullit kjo bëhet në marrëveshje me prindërit.

Integrimi

Në kopshtin e fëmijëve takohen fëmijët me aftësi të ndryshme, me gjuhë dhe kultura të ndryshme. Këto veçanti do të shfrytëzohen si mundësi për të mësuar. Fëmijët mësojnë bashkarisht dhe përfitojnë nga njëri tjetri.

Qëllimet e arsimimit

Plani mësimor

Në kopshtin e fëmijëve do të punohet sipas një plani mësimor, i cili parashton cilat aftësi dhe shkathësi duhet të nxiten (përkrahen) në kopshtin e fëmijëve.

Përgjegjësitë shoqërore

Si pikë kryesore këtu është zhvillimi shoqëror i aftësive: kontaktimi, njohja, dëgjimi, ndjeshmëria, respekti, loja dhe puna së bashku, respektimi i rregullave dhe zgjidhja e konflikteve. Fëmijët mësohen të njohin ligjshmëritë dhe rregullat e grupit në jetën e përbashkët në një grup të madh. Ata mësojnë se si duhet të vendosen rregullat bashkarisht dhe si mund të zbatohen ato. Ata mësojnë që të harmonizojnë interesat e tyre me interesat e fëmijëve të tjerë. Kjo në planin mësimor do të cilësohet si zhvillim i përgjegjësisë shoqërore.

Vetëpërgjegjësia

Në kopshtin e fëmijëve do të nxiten edhe aftësitë, për të përceptuar rrethin dhe veten, të shprehen dhe të komunikojnë. Fëmijët tregojnë ngjarje, dëgjojnë historira, mësojnë ide të reja. Ata ushrohen të dëgjojnë përpikmërisht, të vrojtojnë me vëmendje dhe përceptimet e tyre t'i përmbledhin me fjalë. Këtu do të shfaqen gjithmonë edhe ndjenjat. Shpikjet, përshtypjet do të shprehen me gjuhë dhe mjete shprehëse (punëdore, shfaqje, etj.). Fëmijët zgjerojnë dhe përsosin aftësitë e tyre motorike.

Në kopshtin e fëmijëve fëmijët veprojnë duke fituar e shtuar vetëbesimin e pavarësimin. Me këtë ata mësohen me sukseset e mossukseset dhe zgjerojnë koncentrimin dhe durimin. Këto aftësi janë të përcaktuara (cilësuar) në konceptin e planit mësimor si vetëpërgjegjësi.

Përgjegjësia për lëndët

Në kopshtin e fëmijëve fëmijët zgjerojnë dhe përsosin aftësitë dhe shkathtësitë e tyre me rrethin dhe shoqërinë: ata eksperimentojnë me materiale të ndryshme. Ata mësojnë t'i përdorin dhe mbajnë në duar veglat e punës, aparatet dhe instrumentet muzikore. Ata i zgjerojnë dhe përpunojnë aftësitë e tyre për kafshët dhe bimët.

Përvojat e njohura të mediave vijnë duke u përpunuar. Gjithmonë vazhdojnë të ushtrojnë në njohjen e rrethit dhe të komunikacionit. Këtu fëmijët përkrahen për të krijuar kënaqësinë në mësim dhe për të zgjidhur probleme. Ata marrin vlerësime dhe ku të jetë e nevojshme qëndrime ndihmëse në eksperimentime të rrugëve zgjidhëse. Ata mësojnë të njohin dhe interpretojnë lidhmëritë (marrëdhëniet) dhe ligjshmëritë. Ata ushtrojnë kujtesën.

Lidhur me këtë do të flitet në planin mësimor për zhvillimin e përgjegjësisë për lëndët.

Format e lojës dhe punës

Të luajturit dhe të mësuarit

Veprimtaria më e rëndësishme në kopshtin e fëmijëve është loja. Fëmijët mësojnë kur luajnë dhe ata luajnë gjatë të mësuarit. Lokali i kopshtit të fëmijëve, mobilimi dhe materialet ofrojnë mundësi optimale dhe gjallëri për lojëra të llojllojshme. Në lojë fëmijët zhvillojnë aftësitë e tyre, thellojnë dhe zgjerojnë përvojat, fitojnë shkathtësi të mëtutjeshme dhe zbulojnë interesa të tjera. Në lojërat e përcjellura do të zbatohen forma të reja të lojërave ose ushtrohen qëllimisht aftësitë. Në lojën e vetëzgjedhur fëmijët zgjedhin vet mjetet dhe mënyrat e lojës, ata vendosin se me cilët fëmijë të luajnë dhe cilat rregulla vlejnë për atë lojë. Këtu fëmijët do të ndihmohen dhe udhëhiqen nga personeli arsimor.

Të mësuarit në forma të ndryshme

Në projekte, në mësim në punëtori, gjatë mësimit të këngëve dhe vjershave, gjatë shikimit të librave me fotografi, gjatë dëgjimit të tregimeve fëmijët kanë mundësi të shumëllojshme, që aftësitë e synuara të tyre t'i zhvillojnë më tutje.

Bashkëpunimi i prindërve dhe personelit arsimor

Informimi reciprok

Kopshti i fëmijëve mbështetë familjen në edukimin dhe arsimimin e fëmijës. Nëpërmjet informatave të rregullta reciproke dhe bisedave do të sqarohen parashikimet dhe qëllimet. Fëmijët shpesh sillen krejt ndryshe në kopshtin e fëmijëve në krahasim me sjelljet në rrethin shtëpiak.

Prindërit dhe personeli arsimor këmbëjnë vrotimet dhe përvojat, që t'i kuptojnë fëmijët sa më mirë dhe që të mund t'i mbështesin dhe ndihmojnë ata sa më mirë.

Bisedat Me çdo familje zhvillohet të paktën një bisedë në vit.

Format e ndryshme të bashkëpunimit Personeli arsimor për kopshtet e fëmijëve marrin kontakt me prindërit që në fillim të vitit shkollor të kopshtit të fëmijëve, për të krijuar një bazë të qëndrueshme për një bashkëpunim. Personeli arsimor ka mundësi të vendosë forma të ndryshme bashkëpunimi me prindërit (mbledhjet e prindërve, letrat e prindërve, bisedat, shfaqjet për prindërit dhe fëmijët).

Vizitat Vizitat e prindërve në kopshtin e fëmijëve janë të mirëpritura në marrëveshje me personelin arsimor.

Kalimi nga kopshti i fëmijëve në shkollë

Bashkëpunimi Fëmijët fillojnë në kopshtin e fëmijëve një rrugë të cilën ata do ta vazhdojnë në shkollë. Kopshti i fëmijëve dhe shkolla kanë qëllime të njëjta: ato nxisin vetëpërgjegjësinë, përgjegjësinë shoqërore dhe përgjegjësinë e fëmijëve për lëndët. Edhe pranë planeve të ndryshme mësimore dhe formave të ndryshme të të mësuarit dhe mësimimit ato marrin një detyrë të përbashkët, organizojnë në vazhdimësi kalimin nga kopshti i fëmijëve në shkollë.

Hyrja në shkollë Parimisht të gjithë fëmijët, të cilët para 1 majit kanë mbushur moshën 6 vjeçare, shkojnë në gusht në shkollë. Moshja e përafërt e shkollimit do të caktohet nga kopshti i fëmijëve dhe shkolla.

Vendimin mbi një kthim eventual ose shkollimin në një klasë të vogël e sjell komisioni shkollor pas dëgjimit të prindërve, personelit arsimor të kopshtit të fëmijëve si dhe një instance të specializuar.

Vendimin për hyrje të parakohëshme në shkollë e sjell komisioni shkollor i mbështetur në kërkesën e prindërve si dhe kërkesës së arsyetuar të një këshillimoreje kantonale për edukim dhe arsimim.

Përgjegjësitë

Personeli arsimor për kopshtin e fëmijëve

Për pyetje rreth kopshtit të fëmijëve dhe zhvillimit të fëmijës tuaj mund të pyetni personelin arsimor të kopshtit të fëmijëve, ose udhëheqësinë e shkollës, përkatësisht udhëheqësinë e kopshtit të fëmijëve në komunën tuaj. Sapo fëmija juaj të jetë caktuar në një kopsht, personeli arsimor i atyshëm është personel i përshtatshëm për të gjitha pyetjet dhe kërkesat në lidhje me zhvillimin dhe vijimin e fëmijës tuaj në kopsht.

Komisioni shkollor

Komisioni shkollor, gjegjësisht i kopshtit të fëmijëve është përgjegjës për çështje administrative dhe organizative. Ai i ndan fëmijët nëpër klasë të veçanta.

Inspektoriati shkollor

Mbikqyrjen e specializuar mbi kopshtin e fëmijëve e ka inspektoriati shkollor.

Instancat e specializuara

Këshillimoret për edukim dhe arsimim në rrethin tuaj, shërbimi psikiatrik për fëmijë dhe të rinj si dhe shërbimi shkollor mjekësor ju këshillojnë në raste të veçanta në zhvillimin e fëmijës tuaj dhe për çështje të veçanta për edukim dhe arsimim.